



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 109 prot.

Tiranë, më 01.02.2023

**VENDIM**  
**Nr.8, datë 01.02.2023**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË**  
**VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 136, DATË 11.11.2022.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, Drejtorit të Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit dhe Drejtorit të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 136, datë 11.11.2022, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë në lidhje me procedimin disiplinor; të drejtën e kushteve të përshtatshme të punës; respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të nëpunësit civil; si dhe vlerësimin e rezultateve në punë ndaj inspektorit \*\*\*\*\*”, pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”,

**KONSTATOVA SE:**

Nëpërmjet një informacioni me objekt: “Ankesa lidhur me shkeljet flagrante të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, ndaj inspektorit \*\*\*\*\*”, janë ngritur pretendime se janë lejuar paligjshmëri lidhur me procedurën disiplinore të zhvilluar nga organi disiplinor, vlerësimin e rezultateve në punë, si dhe me mosrespektimin e disa prej të drejtave dhe detyrimeve të nëpunësit civil, ndër të cilat: “E drejta e kushteve të përshtatshme të punës dhe e drejta e mbrojtjes nga shteti” dhe “Detyrimi i përgjegjshmërisë dhe refuzimit të urdhrave të paligjshëm”, parashikuar respektivisht nga nenet 33 dhe 43, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Pas shqyrtimit të të dhënave që përmbante informacioni i përcjellë, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ mbi çështjen në fjalë.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr. 136, datë 11.11.2022, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë në lidhje me procedimin disiplinor; të drejtën e kushteve të përshtatshme të punës; respektimin e të

*drejtave dhe detyrimeve të nëpunësit civil; si dhe vlerësimin e rezultateve në punë ndaj inspektorit \*\*\*\*\**, pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”.

Mbështetur në detyrat e lëna në vendimin nr. 136, datë 11.11.2022, organi publik, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, duhej të kryente veprimin e parashikuar në pikën 1, të Vendimit Paralajmërues, si më poshtë:

*“Komisioneri ka kërkuar nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, marrjen e masave të menjëhershme për përsëritjen e procesit të vlerësimit nga ana e zyrtarit raportues, Drejtori i Drejtorisë së Pronësisë Intelektuale, së bashku me zyrtarët kundërfirmues dhe autorizues, për nëpunësin \*\*\*\*\**, për periudhën e vlerësimit 01.01.2022-30.06.2022, duke respektuar me korrektesë dhe koherencë, kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil dhe duke evituar parregullsitë e përshkruara në pjesën e mësipërme të këtij vendimi”.

Në përfundim të afatit të caktuar në vendimin e mësipërm, në kuadër të zbatimit të vendimit nr. 136, datë 11.11.2022, të Komisionerit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, me shkresën nr. 3440/5 prot, datë 02.12.2022, me lëndë, ”Kthim përgjigje shkresës nr.622/4, datë 11.11.2022”, administruar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 622/6 prot, datë 05.12.2022, ka njoftuar mbi realizimin e përsëritjes së procesit të vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësin civil \*\*\*\*\* në përputhje me parashikimet e vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, duke bashkëlidhur formularin përkatës.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 136, datë 11.11.2022, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë në lidhje me procedimin disiplinor; të drejtën e kushteve të përshtatshme të punës; respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të nëpunësit civil; si dhe vlerësimin e rezultateve në punë ndaj inspektorit \*\*\*\*\*, pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, duke zbatuar detyrimet e Vendimit nr. 136, datë 11.11.2022.
3. Për këtë vendim të njoftohet Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**